



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria -Vlada-Government

Ministria e Punëve të Brendshme-Ministarstoo Unutrašnjih Poslova-Ministry of Internal Affairs

Akademia e Kosovës për Siguri Publike/Kosovska Akademija za Javnu Bezbednost
Kosovo Academy for Public Safety

Me datë: 10.02.2017

Akademia e Kosovës për Siguri Publike

RI SHPALL KONKURS

Për angazhim me honorar të personelit akademik në Fakultetin e Sigurisë Publike, për vitin akademik 2016/2017

I. Drejtimi: Shërbimi Korrektues dhe Sprovues

Nr.	Lëndë	Semestri
1.	Puna në komunitet	veror

Konkursi është intern (brendshëm) andaj të drejtë aplikimi kanë vetëm zyrtaret e punësuar në Shërbimin Korrektues dhe Shërbimin Sprovues të Kosovës.

Kandidatet e interesuar duhet të kenë gradë shkencore se paku master/magjistraturë apo ekuivalent dhe përvojë profesionale në fushën e lëndës që aplikon.

Përzgjedhja e personelit të angazhuar do të bëhet në pajtim me dispozitat e Rregullores për arsimin e lartë në Akademinë e Kosovës për Siguri Publike.

Kompensimi për personelin e angazhuar (me honorar) do të bëhet vetëm për orët e mbajtura, në përputhje me dispozitat e Rregullores (QRK) – Nr.25/2013 për Pagesat e personelit Trajnues dhe Mësimdhënës si dhe Eksperteve të fushave Funktionale.

Kandidatet që paraqiten në konkurs duhet t'i paraqesin këto dokumente: kërkesën me biografi, kopjen e letërnjoftimit, kopjen e diplomës përkatëse të noterizuar, kontratën e punës dhe një vërtetim se i njëjti është në marrëdhënie pune në institucionin përkatës, dëshmitë për publikimet shkencore dhe profesionale, vendimin për nostrifikimin e diplomës (kandidatet që kanë mbaruar studimet jashtë vendit), si dhe informatat e tjera specifike shtesë, të cilat janë të rëndësishme për ata që aplikojnë.

Të gjitha dokumentet duhet të dorëzohen në kopje fizike në Akademinë e Kosovës për Siguri Publike, në Vushtrri, Ndërtesa e Administratës, Zyra e Personelit nr.01.

Si informata të sakta dhe të vërteta do të konsiderohen vetëm ato informata, të cilat janë të dëshmuara me dokumente (jo ato që janë vetëm të deklaruara pa dëshmi).

Konkursi mbetet i hapur **8 ditë** kalendarike nga dita e shpalljes, respektivisht deri me datën **17.02.2017, në ora 16:00.**

Aplikacionet e arritura pas afatit, si dhe ato të pakompletuara nuk do të merren në shqyrtim.

Për shkak të numrit të madh të aplikacioneve, do të njoftohen vetëm kandidatet e përzgjedhur për angazhim me honorar.

Për informata me të hollësishme mund të kontaktoni Divizionin për Burime Njerëzore, në numrin e tel: 028 590 070 Ext 210, prej orës 08:00 - 1600.